



Pranimi / Dorezuar Priljenj / Protobato Received / Delivery	06-04-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTOK	3358	2023	116



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.388/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.388/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 05.04.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa A.nr.388/2023 e datës 22.02.2023, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. *Ndryshohet* Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 30.01.2023 për ankuesin lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit, dhe atë nga nota 2.06-mjaftueshem, në notën 2.8-mirë.
- III. Ky vendim zëvendëson formularin si pikën II dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale të ankuesit dhe në regjistrat përkatës të nëpunësve civil.
- IV. *Obligohet* Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Birimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit, të ndër marrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Komunën e Hanit të Elezit, më datë 22.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolloi 1967/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për



Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, me pretendimin së vlerësimi përfundimtar i punës është jo real dhe subjektiv.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Hanit të Elezit. Ndërsa, Këshilli me datë 13.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 1967/2023 të datës 22.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për pushim vjetor e datës 20.12.2022; Vendimin për pushim vjetor i datës 30.12.2022; Emailin e datës 31.01.2023 nga ankuesi për L.B; Emailin e datës 30.01.2023 nga L.B për ankuesin; Listën e pagave për ankuesin për muajin dhjetor 2022; Emailin e datës 07.02.2023 nga Zyra e Prokurimit për lidhur me raportin e punës për vitin 2022; Raportin e punës për vitin 2022 për Zyrën e Prokurimit i datë 30.12.2022; Emailin e datës 31.01.2023 nga Zyra e Prokurimit për KRPP lidhur me raportin e punës për vitin 2022; Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike në vlerën mbi 1000 Euro dhe nën 1000 Euro; Shkresë për Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit i datë 12.01.2022; Formularin datës 30.01.2023 për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2021; Mirënjohje qershor 2018 për ankuesin; Mirënjohje e datës 20.12.2016 për ankuesin; Certifikatë trajnimi shkurt 2022, gusht 2011, mars 2021, prill 2021; Certifikatën e Avancuar Profesionale për Prokurim me Nr.306 e vitit 2020; Certifikatën e Themelore Profesionale për Prokurim me Nr. 377; Certifikatën Ref.nr.357/2-01 e datës 08.07.2008; Certifikatën për periudhën 18-19.09.2015; Certifikatën nëntor 2018; Akt Emërimit e datës 30.12.2011; Raportin Specialistik i datës 06.01.2022; Kontratën për ekspert të jashtëm profesional të prokurimit dhe ekspert të jashtëm teknik sipas nevojave të OSHP-së i datës 23.09.2020; Kontratën e Punës me Nr.09/9520/2022 e datës 11.11.2022; Kontratën për Furnizim me Nr.09/4307/2022 e datës 16.06.2022; Kontratën për furnizim me Nr. 09/3829/2022 e datës 26.05.2022; Kontratën për Furnizim me Nr.09/4645/2022 e datës 24.06.2022; Kontratën për Shërbime me Nr.09/9581/2022 e datës 17.11.2022; Kontratën për furnizim me Nr.09/3819/2022 e datës 27.05.2022; Kontratën për furnizim me Nr. 09/8869/2022 e datës 19.10.2022; Kontratën e Punës me Nr.09/9843/2022 e datës 29.11.2022; Kontratë Furnizimi me Nr. 09/9956/2022 e datës 06.11.2022; Kontratën për shërbime me Nr.09/0574/2022 e datës 17.11.2022; Kontratë për shërbime me Nr. 09/9482/2022 e datës 10.11.2022; Kontratën për punë me Nr. 09/9298/2022 e datës 04.11.2022; Kontratën për punë shtresë me Nr.09/10345/22 e datës 22.12.2022; Kontratën për shërbim me Nr. 09/4903/2022 e datës 23.06.2022; Kontratë për furnizim-shërbim me Nr. 09/6952/2022 e datës 22.08.2022; Kontratën për furnizim me Nr. 09/3701/2022 e datës 24.05.2022; Kontratë për furnizim me Nr. 09/5008/2022 e datës 05.07.2022; Kontratën për furnizim me Nr. 09/8106/2022 e datës 22.09.2022; Kontratën për furnizim me Nr. 09/9991/2022 e datës 07.12.2022; Kontratën për furnizim me Nr. 09.8686/2022 e datës 07.10.2022; Kontratën për punë me Nr. 09/3664/2022 e datës 21.07.2022; Kontratën për shërbime me Nr. 09/3154/2022 e datës 06.05.2022; Kontratën për shërbim me Nr. 09/2466/2022 e datës 01.04.2022; Kontratën për furnizim me Nr. 09/5722/2022 e datës 22.07.2022; Kontratën për Punë me Nr. 09/8283/2022 e datës 30.09.2022; Kontratën për punë me Nr. 09/8522/2022 e datës 07.10.2022;



Kontratë për punë me Nr.09/2224/2022 e datës 22.03.2022; Kontratë për punë me Nr. 09/8677/2022 e datës 13.10.2022; Kontratë për furnizim me Nr. 09/10343/2022 e datës 22.12.2022; Kontratën për furnizim me Nr.09/9968/2022 e datës 06.12.2022; Kontratën për shërbime me Nr.09/3517/2022 e datës 17.05.2022; Kontratën për punë me Nr. 09/8705/2022 e datës 11.10.2022; Kontratën për punë me Nr 09/9300/2022 e datës 04.11.2022; Kontratën për punë me Nr. 09/5752/2022 e datës 22.07.2022; Kontratën kornize për shërbime me Nr. 09/10159 e datës 14.12.2022; Kontratë për shërbime me Nr. 09/3816/2022 e datës 26.05.2022; Kontratë për shërbime me Nr. 09/9270/2022 e datës 02.11.2022; Kontratë për shërbim me Nr.09/8395/2022 e datës 04.10.2022; Kontratën për shërbime me Nr. 09/9480/2022 e datës 09.11.2022; Kontratë për punë me Nr. 09/6646/2022 e datës 17.08.2022; Kontratë për shërbime me Nr. 09/9534/2022 e datës 10.11.2022; Kontratën për furnizim me Nr. 09/4475/2022 e datës 22.06.2022; Kontratën për shërbime me Nr. 09/8691/2022; Kontratën për shërbime me Nr. 09/7956/2022 e datës 20.09.2022; Kontratën për shërbime me Nr.3254/2022 e datës 06.05.2022; Kontratën për punë me Nr.09/9715/2022 e datës 22.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2221/2023 e datës 01.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2567/2023 e datës 13.03.2023; Raportin e Auditimit për Pasqyrat e Financave Vajtore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit; Raportin final të Auditimit të Brendshëm në Komunën e Hanit të Elezit i datës 28.10.2022; Raporti javor për periudhën 14-18.03.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 21-25.03.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 28.03.2022 deri 01.04.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 04-08.04.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 11-15.04.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 19-22.04.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 04-06.05.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 06-10.06.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 23-27.05.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 16-20.05.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 10-13.05.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 13-17.06.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 20-24.06.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 18-22.07.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 25-29.07.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 07-11.03.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Raporti javor për periudhën 28.02.2022 deri më datë 04.03.2022 nga Zyrtar i Prokurimit për Kryetarin e Komunës; Procesverbalet e Bordit të Drejtoreve me 02.Nr.1293/2022 i datës 22.02.2022; 02/Nr.1650/2022 i datës 07.03.2022; 02/Nr.1829/2022 i datës 11.03.2022; 02/Nr.2039/2022 i datës 18.03.2022; 02/Nr.2214/2022 i datës 25.03.2022; 02/Nr.2424/2022 i datës 01.04.2022; 02/Nr.2590/2022 i datës 07.04.2022; 02/Nr.2733/2022 i datës 15.04.2022; 02/Nr.2899/2022 i datës 26.04.2022; 02/Nr.3167/2022 i datës 10.05.2022; 02/Nr.3355/2022 i datës 13.05.2022; 02/Nr.3599/2022 i datës 20.05.2022; 02/Nr.3833/2022 i datës 30.05.2022; 02/Nr.4026/2022 i datës 06.06.2022; 02/Nr.4207/2022 i datës 14.06.2022; 02/Nr.4555/2022 i datës 27.06.2022; 02/Nr.4853/2022 i datës 04.07.2022; 02/Nr.5702/2022 i datës 25.07.2022; 02/Nr.5915/2022 i datës 01.08.2022; 02/Nr.6179/2022 i datës 05.08.2022; 02/Nr.6470/2022 i datës 12.08.2022; 02/Nr.6728/2022 i datës 22.08.2022; 02/Nr.7221/2022 i datës 01.09.2022; 02/Nr.7320/2022 i datës 05.08.2022; 02/Nr.9525/2021 i datës 10.12.2021; 02/Nr.9655/2021 i datës 17.12.2021; 02/Nr.4265 i datës



17.06.2022; 02/Nr.8080 i datës 23.09.2022; 02/Nr.8523 i datës 07.10.2022; 02/Nr.279/2022 i datës 13.01.2022; 02/Nr.235/2022 i datës 10.01.2022; 02/Nr.1293/2022 i datës 22.02.2022; 02/Nr.8630/2022 i datës 12.10.2022; 02/Nr.9895 i datës 02.12.2022; 02/Nr.9748 i datës 25.1.2022; 02/Nr.9594 i datës 21.11.2022; 02/Nr.9438 i datës 11.11.2022; 02/Nr.9305 i datës 06.11.2022; 02/Nr.7594/2016 i datës 29.07.2016; 02/Nr.8574/2021 i datës 02.11.2021; 02/Nr.9527/2020 i datës 30.12.2020; 02/Nr.8786/2021 i datës 10.11.2021; 02/Nr.7279/2021 i datës 22.09.2021; 02/Nr.75790/2021 i datës 30.09.2021; 02/Nr.7708/2021 i datës 06.10.2021; 02/Nr.8024/2021 i datës 19.10.2021; 02/Nr.8368/2021 i datës 27.10.2021; 02/Nr.4492/2017 i datës 15.06.2017; Vërejtje me numër protokollo 02/366 e datës 18.01.2022; Vendimin A.nr.72/2022 i datës 15.03.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesi është e punësuar në Komunën e Hanit të Elezit dhe se i njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 30.12.2011 ushtron pozitën e punës *Shef i Zyrës së Prokurimit*.

Me tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejt të ankuesit, me datë 30.01.2023 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022, me notë të përgjithshme 2.06.

Ankuesi i pakënaqur me këtë vlerësim ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punës dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike. Shton së vlerësimi është jo i drejt dhe subjektiv sepse ka përmbushur të gjitha objektivat që ka pasur si shef i prokurimit duke mos pasur asnjë rekomandim negativ nga KRRP, OSHP apo AQP.

Bazuar në përgjigjen në ankesë, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit, vlerësimin e rezultateve të ankuesit për vitin 2022 e bazon në Raportin e Auditorit të Zyrës Kombëtare për vitin 2021, duke theksuar së ka pas të gjetura në Çështjet A4 lidhur me vlerësimin e tenderëve dhe çështjet A6 lidhur me nënshkrimin e kontratave publike pa zotim paraprak të mjeteve. Tutje shton së ankuesi nuk ka shkuar asnjëherë në zyrën Kryetarit të Komunës për të diskutuar lidhur me punën, nuk ka marr pjesë në asnjë mbledhje të Bordit të Drejtorëve, asnjëherë nuk ka raportuar por këtë e ka bërë z. \_\_\_\_\_ si Zyrtar i prokurimit dhe së ankuesi ka masë disiplinore në fuqi e cila është vërtetuar me vendim të Këshillit.

Kolegji në kuptim të vendosjes meritorë ju referuar nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: 1. *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues.* 2. *Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit.* 3. *Objektivat*



përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.. 6. Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime me nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuar për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim. 7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi. 8. Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. 9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit... dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues..,

Lidhur me ligjshmërinë e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe si rrjedhojë ka konstatuar së Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, vlerësimin e rezultateve të punës së ankuesit për vitin 2022 e ka bazuar në të gjeturat nga Auditori i Jashtëm referuar fushës së prokurimit, ndërsa më asnjë provë nuk është vërtetuar së Kryetari i Komunës gjatë vitit 2022 ka dhënë vërejtje lidhur me këto të gjetura ndaj zyrtareve përgjegjës të komunës sipas fushave të përgjegjësive, përfshirë edhe ankuesin si përgjegjës të njësisë së prokurimit. Ndërlidhur me këtë, Kolegji po nga shkresat e kësaj çështje nuk verën prova nga të cilat rezulton së ankuesi ka pas vërejtje lidhur me mos përmbushjen apo refuzimin për përmbushje të detyrave të punës, por që i njëjti ka prezantuar evidenca lidhur me realizimin e aktiviteteve të prokurimit për vitin 2022.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës respektivisht sipas raporteve javore të Zyrës së Prokurimit të Komunës së Hanit të Elezit, konstatoj së këto raporte nuk janë dërguar të Zyra e Kryetarit të Komunës nga ankuesi në cilësi të Udhëheqësit të Njesisë së Prokurimit, por këto raporte janë dërguar nga zyrtari i prokurimit . Kurse sipas procesverbaleve të Bordit të Drejtorëve vërehet së ankuesi nuk ka marr pjesë në takimet e këtij bordi, mirëpo nuk ka dëshmi së kjo formë e raportimit dhe mos pjesëmarrja e ankuesit në takimet e Bordit të Drejtorëve të jetë kundërshtuar me shkrim nga Kryetari i Komunës. Në funksion të kësaj Kolegji në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 26 konstaton se Zyrtari publik ka detyrimin të veprorë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit, rrjedhimisht ankuesi në pozitën e Udhëheqësit të Zyrës së Prokurimit në Komunën e Hanit të Elezit, është i detyruar që të raportoj të mbikëqyrësi i drejtpërdrejt në periudha kohore të përcaktuara nga mbikëqyrësi dhe se i njëjti duhet të merr pjesë në takime të vlerësuara nga mbikëqyrësi i ankuesit

Andaj, nisur nga raportet dhe evidencat e prezantuara lidhur me punët dhe aktivitetet e realizuara në vitin 2022 nga Njësia e Prokurimit, e cila drejtohet nga ankuesi, si dhe duke marr parasysh faktin relevant së me asnjë provë nuk dëshmohet së ankuesi nuk ka përmbushur apo ka



refuzuar përmbushjen e detyrave të tij të punës, Kolegji në mbështetje të nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: “Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor , vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)” vendosi që të ndryshoj Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2022, për ankuesin, ashtu që nota e përgjithshme përfundimtare 2.06, ndryshohet me notën e përgjithshme përfundimtare 2.8 e që në kuptim të nenin 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nota nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton vlerësimin “mirë”.

Theksuar si më sipër, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.388/2023

Avdyll BEKTESHI  
  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI  
  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Hanit të Elezit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.